



Prishtinë, datë: 16.08.2023

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Në bazë të Ligjit me Nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me Nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit të Dokumenteve, skanimit dhe ruajtje të tyre – arkivimi elektronik, në lidhje me aktvendimin me numër të protokollit 2331 dt. 12.07.2022 ndaj: “IMA” Sh.P.K , me nr.biznesi 810042789 me adresë; Nënë Tereza, Zona Industriale – Prishtinë me pronar Muhamet Sinani, merr këtë:

AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i i te gjitha shkresave dhe parashtresave për : “IMA” Sh.P.K , me nr.biznesi 810042789 me adresë; Nënë Tereza, Zona Industriale – Prishtinë me pronar Muhamet Sinani, tani e tutje do të bëhet me afishimin e tyre në tabelën e shpalljeve në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit të afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

Arsyetim

Ndaj : “IMA” Sh.P.K , me nr.biznesi 810042789 me adresë; Nënë Tereza, Zona Industriale – Prishtinë me pronar Muhamet Sinani, është lëshuar aktvendimi me numër të protokollit 2331 dt. 12.07.2022.

Në tentim që t'i dorëzohet akti administrativ në përputhje me nenin 7 par. 3 të Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt.16.07.2022 dhe me dt.30.06.2023, është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .


Sali Mulaj
Zëvendësues i Drejtorit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale





Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE (KPMM) në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, ndaj: IMA SH.P.K, me numër unik identifikues 810042789, me seli;Nënë Tereza, Zona Industriale – Prishtinë, me pronare Muhamet Sinani në procedurë administrative me datë 07.07.2022 nxjerr këtë:

AKTVENDIM

1. Ndaj: IMA SH.P.K, me numër unik identifikues 810042789, me seli;Nënë Tereza, Zona Industriale – Prishtinë.
2. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 shqiptohet gjoba administrative për zhvillimin e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar pa posedimin Lejes për Aktivitet të Veçanta në shumën prej 5,000.00 € (pesë mijë euro).
3. Pala ka 15 ditë afat nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi që të kryejë pagesën e shumës së përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit në këtë xhirollogari 1000430070005950.

2331

Arsyetim

12072022

Inspektorati i KPMM-së, gjatë inspektimit të aktiviteteve të jashtëligjshme minerare me datën 02.06.2022 në bazë të autorizimeve dhe obligimeve që dalin nga Ligji Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale ka konstatuar se ndërmarrja IMA SH.P.K, me numër unik identifikues 810042789, është duke ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm minerar. Inspektimi është bërë në lokacionin e objektit minerar në zonën kadastrale; Hajrullah Zymi,Zona Industriale – Fushë Kosovë.

Gjatë inspektimit Inspektorët e Minierave kanë konstatuar se ndërmarrja IMA SH.P.K, është duke kryer aktivitet të jashtëligjshëm minerar pa posedimin e Lejes për Aktivitete të Veçanta – Bazë Betoni i cili është në kundërshtim me dispozitat materiale të pjesës së VI (gjashtë) të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, duke pasur parasysh faktin se në radhë të parë personi që dëshiron të ndërmarrë aktivitete të veçanta duhet të pajiset me lejen për kryerjen e aktiviteteve të veçanta dhe se vetëm atëherë do të mund ti ndërmarr aktivitetet minerare që përfshihen nga të drejtat dhe detyrimet e lejes së veçantë e cila do ti jepte bartësit të lejes të drejtën ekskluzive duke iu nënshtuar kushteve dhe dispozitave të asaj leje.

Inspektorët e Minierave kanë konstatuar se personi në fjalë IMA SH.P.K, aktivitetin e operimeve të jashtëligjshme minerare e zhvillonte në lokacionin me këto koordinata:

Nr.	Y	X	Z
1.	7510010	4722821	558

Në lidhje me këto koordinata IMA SH.P.K, nuk ka poseduar Leje për Aktivitete të Veçanta – Baze Betoni të lëshuar nga organi kompetent i KPMM-së.

Makineria e angazhuar në kryerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm mineralar në vendin e ngjarjes ishte:

- Baze Betonit Statik .
- Luga Ngarkuse KOMATSU WA380-3h, Nr.serik WA380H20956.viti 1999,pa tabela
- Auto Betoni Mikser 2 dyer - Mercedes Benz933,30.
- Auto Betoni Mikser 2 dyer - MAN H36.

Personi në fjalë ditën e inspektimit është urdhëruar me anë të urdhëresës për ndërprerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm mineralar dhe sekuestrimin e mjeteve të punës të lëshuar nga Inspektorët që menjëherë të ndërpres aktivitetin e jashtëligjshëm mineralar.

Duke pasur parasysh faktin që Inspektorati i KPMM me rastin e inspektimit ka konstatuar se personi në fjalë nuk ka poseduar leje për aktivitete të veçanta dhe se aktiviteti mineralar është i jashtëligjshëm dhe është në kundërshtim me dispozitat materiale të pjesës së VI (gjashtë) të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, me këtë raste në përputhje me nenin 79 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i shqiptohet gjoba administrative.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ky akt administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i KPMM-së.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit Shqyrtues për Ankesa të KPMM-së.

Aktvendimi i dërgohet:

- Arkivit të KPMM-së,
- Departamentit të Financave të KPMM-së,
- Palës.

Sali Mulaj
Zëvendësues i Drejtorit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

